REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1120/20
Datë/Datum. 29.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***22.12.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***29.12.2020***	***Nr. i lëndës:*** ***1120/20***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.12.2020, OE NPT "Union"- Mitrovicë, ka parashtruar ankesë me nr: **1120/20,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE Grup i Operatorëve Ekonomik: "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Sherbime të transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e veriut)",*** me nr. të prokurimit: 208 Udheheqesi-20-3492-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontrate publike kornizë me një operator, shërbim, vlera parashikuar e kontratës: 121 500,00 €.

Data e njoftimit për kontratë 20.07.2020, data e hapjes së ofertës 18.08.2020, vendimi i AK-së 01.10.2020, njoftimi per vendimin e AK-rivlerësim 03.12.2020,kërkesa për ri shqyrtim e OE ankues 08.12.2020, vendimi i AK pas kërkesës për rishqyrtim 11.12.2020.

Për këtë AP, PSH me datën 16.11.2020, ka nxjerr vendimin me nr. 825/20.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues pretendon se AK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:
Neni 6, 7, 28, 53, 59, 60, 66, 69 dhe 72 të LPP-së.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Në bazë të dosjes se tenderit si dhe pas vlersimit të parë nga AK ne jemi shpallur si kompani më e lirë ku edhe kemi marrë njoftimin për kontratë. Pra neni 6 i LPP i cili qartëson se operatori më i lirë i përgjegjshëm duhet të shpërblehet me kontratë.Gjithashtu, gjatë rivlerësimit të tenderit AK ka shkelur edhe nenin 7 të LPP-së, pasi që nuk na ka trajtuar si të barabartë OE tjerë.

Neni 28 Specifikimet teknike kemi të bëjmë me një pikë shumë interesante në këtë tender, pasi që si arsye e eliminimit tonë nga ana e OSHP dhe pastaj e AK ka qenë pjesa që ne nuk posedojmë kombi me pjerrinë dhe me HEBEBI pra , si sqarim kryesor në këtë rast mund të jetë qendra e Homologimit të automjeteve se pse ata nuk shënojnë në librezë që mjeti posedon pjerrinë . Gjithashtu ne kemi ofruar një dokument si dhe mundësinë e shikimit live të kombit me pjerrinë për të gjithë vlerësuesit e këtij tenderi. Një kriter që padyshim na ka penalizuar shumë, mirëpo në mënyrë të padrejtë dhe shumë favorizuese per OE DITA dhe JONI të cilët nuk posedojnë mjet me HEBEBI të paktën jo të dorëzuar në këtë dosje të tenderit. Përderisa kemi të bëjmë me dy kritere të lexuara njejtë por të interpretuara ndryshe në favor të njërit operator atëherë padyshim që kjo qështje lë shumë për të dyshuar. Neni 53 Këtu kemi të bëjmë haptazi me shkelje flagrante të LPP pasi që për të gjitha pikat që ne jemi penalizuar nga OSHP gjatë procesit të rivlerësimit AK ka mundur që të kërkojë sqarime shtesë nga ne , pasi që ne vetëm se kemi qenë të shpallur si operator më i përgjegjshëm në vlerësimin fillestar. Neni 59- Këtu kemi të bëjmë me shkelje të LPP pasi që në asnje mënyrë tenderët nuk janë krahasuar ose ekzaminuar në mënyrë të drejtë.

Përderisa njëri operator cilësohet nga komisioni vlerësues si i papërshtatshëm pasi që nuk ka pasur përvoje në lëmi të tillë më herët , pra transport të nxënësve me nevoja të veqanta , atëhere nuk mund ta kuptojmë se si vlerësohet drejtë. Neni 60- kriteri kryesor qmimi më i ulët i ofruar , në kundërshtim të plotë me LPP Neni 66,69 – Siq e keni edhe në përgjigjen e ekspertit për OSHP, mund ta vëreni qartë që operatoret JONI dhe DITA nuk kanë aftësi profesionale që ta përmbushin këtë tender pasi që nuk kanë përvojë të njejtë më herët , gjithashtu nuk posedojnë mjete të punës, KOMBI me HEBEBI kështu që AK ka bërë shkelje të mëdha me këtë rast.

Neni 72 – AK në asnjë rrethanë dhe në asnjë mënyrë nuk ka kërkuar dokumente dhe informacione shtesë si për mjetet e punës, si për kontratat ashtu edhe për të gjitha elementet e tjera të cilat janë cilësuar si të

mjaftueshme për ta kthyer në rivlerësim nga OSHP. ARSYETIM Duke u nisur nga të gjitha pikat e shkelura nga AK si dhe në vendosjen favorizuese dhe të njëanshme nga po e njëjta , ne kërkojmë që ky tender të rikthehet edhe njëherë për vlerësim.

Gjithashtu duhet pasur parasysh edhe mendimin e ekspertit të AK , të dhënë pranë OSHP se ne jemi i vetmi operator i përgjegjshëm dhe se operatori tjetër i cili tanimë ka marrë njoftimin për kontratë nuk është i përshtatshëm për këtë tender, nuk ka përvojën si dhe nuk ka teknikën e nevojshmë.Gjithashtu ju e keni tanime mendimin e ekspertit te AK , mendim i cili asesi nuk duhet te neglizhohet dhe duhet te mirret per baze , qe rivleresimi i bere nga ana e AK te hidhet poshte, lenda te rikthehet serish ne rivleresim dhe te kerkohen dokumente shtese nga ana jone ne menyre qe te qartesohen edhe ato pika diskutabile ne tender.

Perveq shkeljeve esenciale te dispozitave te LPP,ne kete rivleresim ka edhe shkelje te medha te kodit penal te Republikes se Kosoves,duke pasur per baze demtimin e bugjetit te shtetit , tendencen per te na demtuar qellimisht , favorizimin e tjetrit ... Mirepo demi me i madh ketu i shkaktohet femijeve me nevoja te veqanta , te cileve u mohohet e drejta per nje sherbim cilesor dhe adekuat.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme në tri vitet e fundit dhe vlera e tyre ka qenë minimum 182.250.00€ euro.** **2. Mjetet për realizimin e transportit rrugor. - Duhet të posedoj 6 kombibus**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1) Për piken 1. Një Listë e kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit duke saktësuar sherbimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), po ashtu duke i bashkangjitur referencat përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses. (kopje).** **2. Të dëshmoj se posedon mjete te mjaftueshme për realizimin e transportit rrugor. 5 kombibus të jenë normal, 1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjën nxënës me karroca**

				(HEBEBIN). Të dëshmohen përmes librezave, kobibusët duhet të jenë me regjistrim. - Kombibuset duhet te jene te vegjël 8-10 ulëse, sepse duhet te merren nxënësit edhe neper rrugica te ngushta. - Njeri nga kombibuset duhet te ketë pjerrina -rampen) për nxënësit me karroca (HEBEBIN). - Klimë për ngrohje gjatë kohës së dimrit kur është ftohte dhe për ftohje gjate verës kur është nxehtë. - Karriget te kenë rripin e sigurisë për secilin nxënës. - Ndihma e pare ne gjendje te regullt.	
			3. Të dëshmoj se ka stafe të mjaftueshëm për realizimin e transportit rrugorë • Te ketë se paktën 6 punëtor (shofer) me përvojë minimumi 3 vjet, në transport të këtyre personave me aftësi te kufizuar.	**3.Të dëshmoj se ka stafe të mjaftueshëm për realizimin e transportit rrugorë .Lista e stafit (shoferëve) me kualifikimet përkatëse me të cilat disponon operatori ekonomik si patentë shoferet, kontratat ose para kontratat e shofereve dhe CV e tyre.**	

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim: Ministria e Arsimit. shpërblen me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik: "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, në vlerë totale prej 108.371,20 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: AK - Ministria e Arsimit gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër eliminimit të OE ankues dhe propozimit për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit të ofertave. Eksperti shqyrtues pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes sqaron se OE ankues NPT "Union"- Mitrovic fillimisht ka qen i rekomanduar për kontratë, ndërsa pas ankese në OSHP-së, dhe vendimit PSH.nr.825/20, i cili vendim lënden e kthenë në rivlerësim. AK përmes ri-vlersimit OE ankues, e eliminon me arsyetimin si në letër standarde i mungon 1 kombibus duhet të ketë pjerrinë-rampë për bartjen e nxënësve me karroca (HEBEBIN).

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113) OE NPT "Union"- Mitrovicë

Lidhur me pretendimin e tani ankuesit OE NPT "Union"- Mitrovicë, ku pretendon se në bazë të dosjes së tenderit si dhe pas vlerësimit të parë nga AK, ne jemi shpallur si kompani më e lirë, ku edhe kemi marrë njoftimin për kontratë. Pra neni 6 i LPP i cili qartëson se operatori më i lirë i përgjegjshëm duhet të shpërblehet me kontratë. Gjithashtu, gjatë rivlerësimit të tenderit AK ka shkelur edhe nenin 7 të LPP-së, pasi që nuk na ka trajtuar si të barabartë OE tjerë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ishte shpallur fitues herën e parë dhe pas ankesës së parashtruar nga OE tani i rekomanduar për kontratë "JONI TRAVEL" SH.P.K, në lidhje me kombi me pjerrinë dhe me HEBEBI, si dhe kombit tjerë, eksperti edhe në ankesën paraprake edhe tani sqaron se OE ankues NPT "Union"- Mitrovicë nuk posedon kombit sipas kërkesës së AK-së sepse disa kombi janë me ulëse mbi 20 vende, kurse AK kishte kërkuar kombi prej 8 deri 10 vende për shkak të rrugicave dhe rrugëve të ngushta në fshatra. Pra, eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues se AK nuk ka vepruar sipas nenit 6 të LPP-së është i pa bazuar sepse kjo dispozitë obligon autoritetin kontraktues që të arrij ekonoicitetin dhe efiskasitetin, që nënkupton të paguaj çmimin më të lirë kur operatorët ekonomik i përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit.

OE ankues NPT "Union" – Mitrovicë, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 Specifikimet teknike, kemi të bëjmë me një pikë shumë interesante në këtë tender, pasi që si arsye e eliminimit tonë nga ana e OSHP dhe pastaj e AK ka qenë pjesa që ne nuk posedojmë kombi me pjerrinë dhe me HEBEBI. Pra, si sqarim kryesor në këtë rast mund të jetë qendra e Homologimit të automjeteve se pse ata nuk shënojnë në librezë që mjeti posedon pjerrinë. Gjithashtu, ne kemi ofruar një dokument si dhe mundësinë e shikimit live të kombit me pjerrinë për të gjithë vlerësuesit e këtij tenderi. Një kriter që padyshim na ka penalizuar shumë,

mirëpo në mënyrë të padrejtë dhe shumë favorizuese për OE DITA dhe JONI të cilët nuk posedojnë mjet me HEBEBI të paktën jo të dorëzuar në këtë dosje të tenderit. Përderisa kemi të bëjmë me dy kritere të lexuara njëjtë por të interpretuara ndryshe në favor të njërit operator atëherë padyshim që kjo çështje lë shumë për të dyshuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se në ekspertizën paraprake, ku OE ankues ishte "JONI TRAVEL" SH.P.K dhe kishte parashtruar ankesë kundrejt OE NPT "Union" – Mitrovicë, janë dhënë sqarime, ku konstatimet nga ana e ekspertit shqyrtues ishin:

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë përmes ofertës ka prezantuar këto mjete:

1. Ford kombi me 9 ulëse, me regjistrim deri me datë 13.12.2020 dhe me targa të regjistrimit 02-949-BO;
2. Volksëagen kombi bus me 9 ulëse, me regjistrim deri me 15.07.2021 dhe tabela 02-103-AE, ka marreveshje per qira;
3. Volksvagen kombi me 7 ulëse, me regjistrim deri me 03.12.2020 dhe tabela 02-790-DR, ka marreveshje per qira;
4. Volksvagen kombi 8 ulese, me regjistrim deri me 03.08.2021 dhe me tabela 02-190-DR, ka marreveshje per qira;
5. Volksvagen 70xOB me 9 ulëse, me regjistrim deri me 20.11.2020 dhe me tabela 02-837-CI, Ka marrëveshje për qira;
6. Volksvagen Typ me 7 ulëse, me regjistrim deri me 28.01.2021 dhe me tabela 02-328-BP, Ka marrëveshje për qira;
7. Mercedes Benz 416 për 25 udhëtar, me tabela 02-253-DD dhe me regjistrim deri me 01.06.2021, CDI 904.6, AUTOBUS 3 DYER;
8. Minibus 3 për 20 udhëtar, tabela 02-458-DH, regjistrim deri me 25.11.2020, ka marrëveshje;
9. Mercedes 410 për 20 udhëtar, regjistrim deri me 13.12.2020, tabelat 02-650-CM;
10. Mercedes Mini bus per 20 udhëtar, regjistrim deri me 22.06.2021, tabela 678-KS-763.

Për mendimin e ekspertit shqyrtues, këto mjete nuk e plotësojnë kërkesën e AK-së. Megjithatë, AK gjatë ri-vlerësimit duhet të kërkoj sqarime shtesë dhe të sigurohet nëse OE i rekomanduar e plotëson këtë kërkesë me listën e mjeteve të cekura si më lartë dhe të vërtetoj se kombibus *1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjën rxënës me karroca HEBEBIN*, se a e posedon i njeti. Andaj, pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pra, në ekspertizën paraprake është konstatuar se OE ankues i posedon vetëm 4 kombi konform kërkesës së AK-së që është kërkuar nga 8 deri në 10 vende ulëse. Numri i vendeve për udhëtar është marrë nga librezat të cilat OE ankues i ka në ofertë Andaj, këto mjete nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse kërkesë e AK-së ka qenë:

2. Mjetet për realizimin e transportit rrugor. - Duhet të posedoj 6 kombibus

Dëshmia e kërkuar dokumentare

2. Të dëshmoj se posedon mjete te mjaftueshme për realizimin e transportit rrugor.

5 kombibus të jenë normal, 1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjen nxënës me karroca (HEBEBIN).

Të dëshmohen përmes librezave, kobibusët duhet të jenë me regjistrim.

- Kombibuset duhet te jene te vegjël 8-10 ulëse, sepse duhet te merren nxënësit edhe neper rrugica te ngushta.

- Njeri nga kombibuset duhet te ketë pjerrina -rampen) për nxënësit me karroca (HEBEBIN).

- Klimë për ngrohje gjatë kohës së dimrit kur është ftohte dhe për ftohje gjate verës kur është nxehtë. - Karriget te kenë rripin e sigurisë për secilin nxënës. - Ndihma e pare ne gjendje te regullt.

Andaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, eksperti shqyrtues konsideron se AK ka vepruar konform nenit 28 të LPP-së. Kurse në lidhje me konstatimin e ekspertit në ekspertizën paraprake që AK të kërkoj sqarime shtesë, eksperti shqyrtues sqaron se në platformën e-prokurimi nuk ka hasur në kërkesë të AK-së për sqarime shtesë nga OE ankues.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues se AK sipas nenit 53, ku potencon se këtu kemi të bëjmë haptazi me shkelje flagrante të LPP pasi që për të gjitha pikat që ne jemi penalizuar nga OSHP gjatë procesit të rivlerësimit AK ka mundur që të kërkojë sqarime shtesë nga ne , pasi që ne vetëm se kemi qenë të shpallur si operator më i përgjegjshëm në vlerësimin fillestar. Neni 59- Këtu kemi të bëjmë me shkelje të LPP pasi që në asnje mënyrë tenderët nuk janë krahasuar ose ekzaminuar në mënyrë të drejtë. Përderisa njëri operator cilësohet nga komisioni vlerësues si i papërshtatshëm pasi që nuk ka pasur përvoje në lëmi të tillë më herët, pra transport të nxënësve me nevoja të veqanta, atëhere nuk mund ta kuptojmë se si vlerësohet drejtë.

Eksperti shqyrtues sqaron se edhe në ekspertizën paraprake edhe në vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.nr.825/20 është obliguar AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Megjithatë, në mungesë të mjeteve të udhëtarëve të cekura si më lartë, edhe sikur të kërkonte sqarime shtesë nga OE ankues nuk do të ndikonte në rezultatin përfundimtar pasi që tenderi i OE ankues nuk i plotëson kërkesat e AK-së në lidhje me kombi busët.

OE ankues pretendon se AK ka shkelut nenin 60 kriteri kryesor çmimi më i ulët i ofruar, në kundërshtim të

plotë me LPP Neni 66, 69 – Siç e keni edhe në përgjigjen e ekspertit për OSHP, mund ta vëreni qartë që operatoret JONI dhe DITA nuk kanë aftësi profesionale që ta përmbushin këtë tender pasi që nuk kanë përvojë të njejtë më herët, gjithashtu nuk posedojnë mjete të punës, KOMBI me HEBEBI kështu që AK ka bërë shkelje të mëdha me këtë rast.

- Eksperti shqyrtues sqaron se neni 60 ka përcaktuar që tenderi do të jepet operatorit ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Në rastin konkret, është e vërtetë që tenderi i OE ankues është më çmim më të lirë por nuk i plotëson kërkesat e AK-së. Kurse, sa i përket pretendimit tjetër se OE i rekomanduar nuk e posedon kombin me HEBEBI, eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar gjendet libreza e regjistrimit me numër të targave 671-KS-168, marrëveshje për "dhënjen me marrëveshje në shfrytëzim të kombibusit me këto të dhëna: Targa: 671-KS-168 me validitet – 01.06.2021", dhe kopjen e librezës për këtë kombi me përshkrimin për persona me nevoja të veçanta (shënim nga qendra e regjistrimit të automjeteve).

  Andaj, ky pretendim është i pa bazuar pasi që OE i rekomanduar e posedon kombi me HEBEBI.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se për këtë pretendim ka dhënë përgjigje në pretendimin më lartë që lidhet me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këte raport propozimi ynë është qe ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe ti lejohet AK-së, të procedoi tutje me aktivitetin e prokurimit, konform dispozitave të LPP-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Ministria e Arsimit
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
  OE ankues - NPT "Union"- Mitrovicë